

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister*

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Raport mbi Zbatimin e Planit të Veprimit (2021-2023) për Programin  
për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të  
Njeriut (2021-2025)

**Periodha e vlerësimit (2023)**

Maj, 2024

## **Përmbajtja:**

1. **Përmbledhje**
2. **PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË PROGRAMIT**
3. **PROGRESI KUNDREJT OBJEKTIVIT:**
  1. Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;
  2. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;
  3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;
  4. Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.
4. **RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE**
5. **SHTOJCA I: Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (2021-2025)**

## Lista e shkurtesave dhe akronimeve;

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AD</b>	Akademia e Drejtësisë
<b>ANJF</b>	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>IAK</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>IKAP</b>	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
<b>IKSHPK</b>	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
<b>KE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KNDESK</b>	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial i Kosovës
<b>LGBT</b>	Lezbike, gej, biseksuale dhe transgjinore
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit rural
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>ME</b>	Ministria e Ekoomisë
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MKKT</b>	Mekanizmi Kombëtar kundër Torturës
<b>MKRS</b>	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>MPBAL</b>	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>NJDNJ</b>	Njësia për të Drejtat e Njeriut
<b>NJKDNJ</b>	Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut
<b>OHCHR</b>	Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>PKZMSA</b>	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>UNHCR</b>	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>ZKM/ZQM</b>	Zyra e Kryeministrit / Zyra për Qeverisje të Mirë
<b>ZL/ZKM</b>	Zyra Ligjore/ Zyra e Kryeministrit

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Është viti i tretë me rradhë që ka vazhduar zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe plani i veprimit tre vjeçar (2021-2023) për zbatimin e tij.

Në bazë të raportimeve nga ana e institucioneve vrehet një angazhimin i shtuar në realizimin e aktiviteteve dhe përmbushjen e objektivave strategjike dhe atyre specifike të parapara në planin e veprimit (2021-2023). I falënderojmë të gjitha institucionet në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes, institucionet e panavrrura jashtë ekzekutivit, agjensionet, Institucionin e Avokatit të Popullit për kontributin dhe bashkëpunimin e ofruar gjatë procesit të hartimit të këtij Raporti.

Përpyekjet kanë qenë të orientuara në fuqizimin e bashkëpunimit dhe Koordinimit ndër-institucional lidhur me zbatimin e aktiviteteve të parapara në kuadër të planit tre vjeçar të veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025)

Me datë 27 tetor 2021, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Programin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025). Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe plani i veprimit tre vjeçar (2021-2023) për zbatimin e tij, ka për qëllim prodhimin e një plani horizontal i cili do të ketë përkrahjen e gjerë të palëve të interesit dhe i cili do të jetë një udhërrëfyes dhe udhëzues konsensual për zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, ligjeve, programeve dhe politikave strategjike në fushën e të drejtave të njeriut, me qëllim të rrisin cilësinë e jetës, të respektojë të drejtat e secilit dhe ofrojnë mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë në arsim, shëndetësi, drejtësi në jetën sociale dhe në shërbimet publike në përgjithësi.

Janë dy mekanizma kryesor përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025), duke përfshi Grupin Koordinues Ndër-institucional për të Drejtat e Njeriut i cili udhëhiqet nga Znj. Emilija Redzeqi, Zëvendëskryeminstre e Republikës së Kosovës (Kryesuese) si dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Me datë: 8 qershor të vitit 2023 është mbajtur takimi i rregullt i Grupit Koordinues Ndër-institucional për të Drejtat e Njeriut, ku është prezantuar për shqyrtim dhe diskutim Raporti i Progresit (2021-2022) mbi zbatimin e Planit të Veprimit (2021-2023) për Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2025).

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025) ka katër objektiva strategjike:

- 1. Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;**
- 2. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;**
- 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;**
- 4. Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.**


Këto objektiva strategjike, ndahen në 16- gjashtëmbëdhjetë objektiva tjera specifike në të cilat bazohet Plan i Veprimit (2021-2023). Raporti i progresit vlerëson situatën lidhur me zbatimin e aktiviteteve të parapara në kuadër të Planit të Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2025), gjatë periudhës **(Janar 2023-Dhjetor 2023)** .

Në tërësi , në Planin e Veprimit për vitin (2021-2023) , të përcaktuara gjithësejt janë 124 aktivitete për institucionet zbatuese. Në vitin 2021 kanë qenë të planifikuara 9 aktivitete ,në vitin 2021-2022 kanë qenë të planifikuara 37 aktivitete si dhe 78 aktivitete të cilat do të zbatohen në vazhdimësi gjatë periudhës (2021-2023). Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve është ndarë në tre kategori:


- 1) të zbatuara plotësisht;
- 2) të zbatuara pjesërisht ose në zbatim e sipër;
- 3) të pazbatuara.

Përderisa deri në muajin dhjetor të vitit 2022 ,nga 124 aktivitete të planifikuara: 74 janë zbatuar plotësisht apo 59.67%, 34 pjesërisht ose janë në zbatim e sipër apo 27.41% ,si dhe 16 nuk janë zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim serioz lidhur me to apo 12.90%, deri në dhjetor të vitit 2023 ,nga 124 aktivitete të planifikuara :104 janë zbatuar plotësisht apo 83.87% ,14 pjesërisht ose janë në zbatim e sipër apo 11.29% si dhe 6 nuk janë zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim serioz lidhur me to apo 4.83%.

**Fig;1** Vlerësimi i përgjithshëm për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të secilit Objektiv Strategjik është si në vijim:Numrat tregojnë numrin e aktiviteteve të zbatuara



**Fig;2** Vlerësimi i përgjithshëm për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të 4 (katër Objektivave Strategjik është si në vijim:



**Numrat në Fig, tregojnë numrin e aktiviteteve të zbatuara, të zbatuara pjesërisht apo në zbatim e sipër dhe ato të pazbatuara.**

Ngjyra e gjelbërt tregon zbatimin e plotë të një aktiviteti

Ngjyra e portokalltë tregon zbatimin e pjesshëm apo se një aktivitet është në zbatim e sipër

Ngjyra e kuqe tregon se aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të

Ky raport është përgatitur bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit si dhe manualin për zbatimin e tij.

## **PËRPARIMI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË PROGRAMIT**

Republika e Kosovës, nëpërmjet kuadrit të saj kushtetues, ligjor dhe institucional, ka mbetë e përkushtuar të zbatoj parimet dhe standardet universale të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e saj pa dallim. Qeverisja e Mirë, sundimi i ligjit dhe barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit janë qëllimi dhe synimi jonë kryesor. Objektivi strategjike e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbetet hartimi dhe zbatimi efektiv i legjisllacionit dhe politikave që përmirësojnë dhe përmbushin të drejtat dhe shërbimet e qytetarëve në vend, me fokus në grupet më të marginalizuara të shoqërisë, duke përfshi fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, personat e pagjetur (zhdukur), viktimat e dhunës seksuale, të moshuarit, komunitetet joshumicë, komunitetin (LGBTI), të kthyerit, personat e zhvendosur, gjatë luftës etj.

Hartimi i Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025), ishte obligim që del nga Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 05/L-021, saktësisht neni 10 i cili e obligon Zyrën për Qeverisje të Mirë të hartojë politika, strategji dhe plane të veprimit në çështjet për mbrojtjen nga diskriminimi. Ky Program është ndërtuar mbi parimet dhe standardet që përcaktojnë qartë se të drejtat e njeriut janë të drejta të natyrshme, të pandashme, të patjetërsueshme dhe universale. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, proklamonte dhe garantonte parimin për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe

barazinë e të gjithëve para ligjit. I bazuar mbi këto parime, Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut synon të arrijë:

- ✚ Barazinë para ligjit, paprekshmërinë e të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve shtetërore, dhe mbrojtjen nga shkelja e të drejtave të njeriut nga të tjerët;
- ✚ Krijimin e një sistemi të qëndrueshëm institucional i cili do t'i lejojë personat të realizojnë dhe zbatojnë të drejtat e tyre në praktikë;
- ✚ Informimin adekuat të popullsisë për të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, ligje dhe instrumente ndërkombëtare.

**Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut parasheh këto objektiva strategjike:**

- ✚ **Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;**
- ✚ **Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;**
- ✚ **Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;**
- ✚ **Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.**

Gjatë periudhës raportuese ka pasë zhvillime pozitive në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave në fushat e të drejtave të njeriut. Qeveria e Republikës së Kosovës i ka dhënë prioritet avancimit , bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional për të drejtat e njeriut .Fokusi ka qenë i orientuar në sigurimin e qasjes në drejtësi për të gjithë dhe për të ndërtuar institucione të cilat udhëhiqen nga parimet e qeverisjes së mirë, janë efektive, të përgjegjshme, transparente llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e qeverisjes .

Qeveria e Kosovës, po synon të promovojë dhe zbatojë një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, të ngrit kapacitetet dhe të vendos një kulturë administrative institucionale në të gjitha resorët e qeverisë, ku respektimi, mbrojtja, promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut bëhet pjesë e kulturës së përgjithshme të punës të çdo zyrtari që ushtron funksione publike dhe ofron shërbime publike për qytetarin.

Gjithësesi, gjatë kësaj periudhe për Qeverinë e Kosovës, prioritet ka qenë zbatimi i rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut, raportuesve special të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, organizatave si dhe mekanizmave vendor; zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit, fuqizimi i sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ), ofrimi i mundësive të barabarata dhe trajtim të barabartë, parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi përmes krijimit të mundësisë që Administrata të krijojë politika publike të cilat kanë për synim përmirësimin dhe avansimn e situatës dhe pozitës së komuniteteve të marginalizuara me anë të zbatimit të masave afirmative, krijimit dhe fuqizimit dhe përditësimit të sistemit të trajnimit për të drejtat e njeriut, fushata edukimi dhe vetëdijësimi për të drejtat e njeriut.

Zyra e Kryeministrit-Zyra për Qeverisje të Mirë, është organi i ngarkuar i cili në bashkëpunim dhe bashkë-koordinim me institucionet e tjera, po monitoron, dhe koordinon procesin e zbatimit, si dhe po monitoron dhe raporton në baza periodike lidhur me zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Për më tepër, Zyra për Qeverisje të Mirë është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Zyra për Qeverisje të Mirë përveq rolit aktiv koordinues, monitorues dhe raportues, ka qenë akterë kyq në ndërmarrjen e shumë veprimeve e nismave në zbatimin e Programit dhe Planit të Veprimit për të Drejtat dhe liritë themelore të Njeriut (2021-2023).

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (2021-2025), po zbatohet në linjë me Planin e Veprimit (2021-2023).

Programi i ka: **4 katër objektiva strategjike, 16 objektiva specifike, 37 tregues** dhe **124 veprime të ndryshme**. Më vijim në këtë raport, është paraqitur përparimi i zbatimit të Programit dhe Planit të Veprimit për vitin (2021-2023). Janë përdorur të gjitha të dhënat në dispozicion nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, agjensionet, ministritë, komunat dhe institucionet e tjera relevante, të mbledhura përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me e-mail. Jo të gjitha institucionet kanë dërguar informacione të kompletuara mbi bazën e të cilave do të mund të bëhej një vlerësim sa më real i zbatimit të aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit (2021-2023).

**Gjatë kohës së raportimit, niveli i zbatimit të aktiviteteve është si në vijim:**

#### **Objektivi Strategjik Nr.1**

**1. Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;**

***Sipas Planit të Veprimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në këtë objektiv strategjik priten dy të arritura kryesore:***

- Të drejtat e njeriut janë vendos në agjendën e prioriteteve të Qeverisë
- Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut i funksionalizuar

**Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:**

- Numri i politikave për të drejtat e njeriut të aprovuara si rezultat i rekomandimeve të Grupit Koordinues Ndërmintistor për të Drejtat e Njeriut.

**Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlidhet me:**

- Numri i takimeve të realizuara gjatë një viti i Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut ku deri në fund të vitit 2023 synohet të realizohen 4 takime

Padyschim, Qeverisja e mirë, transparenca dhe llogaridhënia institucionale janë faktorë kyq për mbrojtje efektive dhe efikase të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të ligjeve dhe politikave për të drejtat e



njeriut. Të drejtat e njeriut nuk mund të realizohen plotësisht pa zbatim efektiv të legjislacionit, politikave, standardeve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut, pa koordinim të mirëfilltë ndërinstitucional, pa mekanizma qeverisës efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm. Gjatë periudhës raportuese ka pas angazhime të shtuara në avansimin dhe zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e të drejtave të njeriut.

Nga përmbledhja dhe analiza e përgjithshme e raportimeve të institucioneve publike në Kosovë, kemi vënë re se janë ndërrmarre veprime të shumta nga ana e institucioneve në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes lidhur me zbatimin e aktiviteve të parapra në kuadër të këtij objekti strategjik dhe objektave specifike .Ka qenë e pamundur të prezantohen të gjitha aktivitetet e ndërrmara nga ana e tyre për arritjen e këtij objekti stategjike ,mirëpo i kemi prezantuar disa që kanë qenë shumë relevante dhe kanë pas ndikim substancial në përmirësimin dhe avansim e të drejtave të grupeve të ndieshme të shoqërisë.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, si mekanizëm kryesor ndërlidhës dhe koordinues ndërmejt Zyrës së Kryeministrit, ministrive dhe komunave në vazhdimësi është duke punuar me institucionet në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të zbatuar në mënyrën e duhur, kornizën ligjore dhe të politikave në fushën e të drejtave të njeriut, (të drejtat e fëmijëve, të drejtave të pjestarëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e pjestarëve të komunitetit (LGBTI), ashtu siq garantohet nga Korniza kushtetuese dhe legjislativ e Kosovës si dhe instrumentet direkt të zbatueshme ndërkombëtare dhe rajonale për të Drejtat e Njeriut.

Me qëllim të avansimit dhe të fuqimizimit të koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e ligjeve dhe politikave për të drejtat e njeriut , duke e përbush rolin e saj në cilësin e Sekretariatit të Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut –Zyra për Qeverisje të Mirë ka ndërmarre të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin dhe mbarvajtjen e punës së këtij mekanizmi. Në takimin e rregullt të Grupit mbajtur në qershor 2023 janë prezantuar për shyrtim dhe diskutim:

- ✚ Raporti i Progresit (2021-2022) mbi zbatimin e Planit të Veprimit (2021-2023) për Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2025)
- ✚ “Situata lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit adresuar institucioneve”(progresi & sfidat).
- ✚ “ Për herë të parë në kuadër të këtij mekanizmi është bërë Prezantimi dhe adresimi i Rekomandimeve të dala nga Raporti i Shoqërisë Civile për të drejtat e njeriut në Kosovë në vitin 2022” .

Ka pas zhvillime pozitive në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të zyrtarve për monitorim dhe raportim konform Koornizë së Indikatorve për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Korniza përmban 42 indikatorë matës, dhe mbi bazën e tyre është hartuar Raporti vjetor 2023 për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi .Ka pas aktivitete të shumta në fushën e promovimit të pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut ,Ligjit kundër dhunës në familje, Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Edhe Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2023 , evidenton që Kapaciteti i autoriteteve për të monitoruar zbatimin e politikave dhe legjislacionit për të drejtat themelore është përmirësuar dhe shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është rritur, gjithashtu evidentohet si progres dhe e arritur hartimi dhe zbatimi i Koornizës së Indikatorve për monitorimin e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Tri raporte vjetore (2021-2022-2023) janë hartuar mbi bazën e kësaj kornize të indikatorëve .

Për herë të parë në vend është hartuar Koorniza e Treguesve ( Indikatorve) për të drejtat e njeriut. Me qëllim që treguesit të ishin sa më të kuptueshëm dhe shterues, metodologjia e hartimit të tyre konsistoi në përgatitjen e treguesve për secilën të drejtë të detyrueshme të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në aktet ndërkombëtare të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Korniza e Treguesve për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, është aprovuar në mbledhjen e radhës së Qeverisë së Kosovës , datë 13.12.2023, me Vendim Nr.20/178. Është hartuar Format i raportimit lidhur me monitorimin e zbatimit të Kornizës së Treguesve të të Drejtave të Njeriut në Republikën e Kosovës, dhe gjatë vitit 2024 do të testohet për herë të parë zbatimi i kësaj koornize të treguesve për të drejtat e njeriut.

ZQM-rë me mbështetjen projektit “ Human Capacity Development Fund (HCDF)” , asistenca teknike në kontekst të integritimit Evropian ka organizuar trajnime me qëllim të aftësisë të mëtejshme të zyrtarëve për të drejtat e njeriut dhe anti-diskriminim nga institucionet e Qeverisë së Kosovës dhe institucione të tjera publike të pavarura të Kosovës për t'u aftësuar për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave publike për të drejtat e njeriut, me fokus në Treguesit e të drejtave të njeriut dhe përdorimi praktik i tyre, gjatë procesit të hartimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të politikave.

Ajo që nuk duhet lënë pa u përmendur dhe që i referohet transparencës dhe llogaridhënjes institucionale, është numri tejet i shtuar i kërkesave për qasje në dokumente publike nga viti në vit.

Gjatë procesit të raportimit të institucioneve publike pranë AIP-së, për vitin 2023 janë regjistruar krejtësisht 4465 kërkesa për qasje në dokumente publike, ndërsa gjatë vitit 2022, ky numër ka qenë 4481 kërkesa për qasje në dokumente publike për të gjitha institucionet publike raportuese.

Agjensioni për Informim dhe Privatësi (AIP) ka gjetur se institucionet publike në përqindje më të lartë respektojnë kriteret e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike, lidhur me publikimin e dokumenteve në faqet e tyre zyrtare .Pas zgjedhjes së Komisionerit për Informim dhe Privatësi dhe pas funksionalizimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi ka rënë dukshëm numri i ankesave që paraqiten në IAP.

Gjatë vitit 2023, Avokati i Popullit ka pranuar 11 ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, 8 nga këto janë shpallur të papranueshme, ndërsa 3 të tjerat janë hapur për hetim. Hetimet për 3 ankesat kanë përfunduar dhe është konstatuar se palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet ligjore në dispozicion dhe nuk i kanë respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Ministria e Shëndetësisë ka pranuar 83 kërkesa për qasje në dokumente publike, ku vetëm për dy kërkesa është dhënë qasje e pjesshme. Ndërsa për 81 kërkesa është ofruar qasje e plotë brenda afatit ligjor.

Ministria e Drejtësisë për periudhën janar – dhjetor 2023 ka pranua 41 kërkesa për qasje, 38 kanë marrë përgjigje të plota, 1 të pjesshme dhe 2 janë refuzuar. Kërkesat e pjesshme dhe të refuzuara janë komform ligjit për Qasje në Dokumente Publike “ e drejta e privatësisë...” dhe “rasti nën hetime”.

Kjo tregon një nivel të lartë të transparencës në institucionet publike, njëkohësisht numri i shtuar i kërkesave për qasje pranë këtyre institucioneve paraqet një vetëdijësim të shtuar të qytetarëve për të realizuar të drejtën e tyre sa i përket qasjes në dokumente publike, e kjo vjen si rezultat i organizimit të fushatave ,takimeve , debateve e tryezave të ndryshme me dhe për qytetarët. Padyshim, kjo situatë reflekton si rezultatat përveq tjerash i anagazhimit të vazhdueshëm i Agjencionit për Informim dhe Privatësi për ngritje të kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës për lejitimin e qasjes në dokumente zyrtare si dhe për të rritur vetëdijësimin dhe ndërgjegjesimin e qytetarëve për të qenë pjesë e vendimmarrjes institucionale, në njërën anë dhe në anën tjetër, për të ngritur përgjegjësinë institucionale për rritjen e transparencës për punën e tyre dhe ofrimin e llogaridhënies për qytetarët.


**Në matricë në mënyrë të detajuar dhe përshkruese është prezantuar statusi i zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të Objektivit Staregjik I ;**

**Në kuadër të Objektivit Staregjik I –janë paraparë 4 Nën-objektiva strategjike me gjithësejt 20 aktivitete. Statusi i zatimit të aktiviteteve është si në vijim:**

**Të zbatuara plotësisht : 19 (nëntëmbëdhjet )**

**Të zbatuar pjesërisht apo në zbatim e sipër: 1 (një )**

**Aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të; 0**



**Krahas përparimit të madh të arritur në këtë objektiv strategjik, disa sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen janë:**

- Të mbahen takimet e rregullta dhe efektive të Grupit Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut.
- Të funksionalizohet Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizim të legjislacionit drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh.
- Funksionalizimi dhe fuqizimi i plotë mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi në qeveri dhe komuna konform Rregullore qrk - nr. 03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në qeveri dhe komuna dhe [Lligjit nr. 05/l -021 për mbrojtjen nga diskriminimi](#) i cili është në proces të plotësim ndryshimit (amandamentimit) apo ndryshimeve dhe risive që do të sjellë plotësim-ndryshimi I Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminim I cili është në proces.
- Të monitorohet dhe raportohet mbi zbatimin e Kornizës së treguesve për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës.

**Objektiva strategjike #2:**

**2. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;**

***Sipas Planit të Veprimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut , në këtë objektiv strategjik priten dy të arritura kryesore:***

- Respektimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut konform standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi;
- Institucionet kanë rritë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).

**Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:**

- Zbatimi i rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, organizatat dhe mekanizmat vendor

**Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlihet me:**

- Prioritizimi dhe shkalla e zbatimit të Rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) deri në fund të vitit 2023 të arrine shkalla e zbtimit në 85%

Një prej kriterëve themelore për zhvillimin e një sistemi funksional të sundimit të ligjit, është respektimi dhe zbatimi i standardeve për të drejtat e njeriut nga institucionet shtetërore. Çdo nënpunës publik konform Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi, është i obliguar ti përmbahet, zbatojë dhe promovojë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve publike. Ato standarde janë relevante si për cilësinë e ligjeve dhe politikave, po ashtu edhe për zbatimin e tyre. Qeveria e Kosovës, përmes kësaj objektive po promovon dhe zbaton një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, gjatë procesit të analizës, planifikimit dhe hartimit të legjislacionit dhe politikave, po vendos

një kulturë administrative institucionale në të gjitha nivelet e qeverisjes, ku respektimi, mbrojtja, promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut bëhet pjesë e kulturës së përgjithshme të punës të çdo zyrtari që ushtron funksione publike dhe ofron shërbime publike për qytetarin.

Në funksion të arritjes së kësaj objektivë, Qeveria e Kosovës është duke i dhënë prioritet zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga mekanizmat ndërkombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut, organizatave si dhe mekanizmave vendorë, zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, fuqizimin e sistemit kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (SKMPDNJ), ofrimit të mundësive të barabarata dhe trajtim të barabartë, parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi përmes krijimit të mundësisë që Administrata të krijojë politika publike, të inicoj dhe zbatojë masa afirmative të cilat kanë për synim përmirësimin e situatës së komuniteteve të marginalizuara.

Me Vendimin e Kryeministrit nr. 6/81 të datës 01.06.2022 është themeluar Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Duhet theksuar se themelimi i Ekipit **është masë e përkohshme afirmative** për inkurajimin, avancimin si dhe për arritjen e kuotës së punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, siç është përcaktuar në Kushtetutë. në ligjin nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe në legjislacionin përkatës në fuqi në Republikën e Kosovës

Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ), ka iniciuar hartimin e një mase afirmative për ngritjen e pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse në administratën publike, ABGJ e ka shtyrë këtë aktivitet për vitin 2024 në mënyrë që masa afirmative të mbështetet në kornizë ligjore të përfunduar. Po ashtu, ABGJ ka mbështetur formimin e shoqatës së grave në pozita vendimmarrëse në administratë publike me qëllim të inkurajimit- mbështetjes, dhe promovimit të vendimmarrjes së grave si masë inkurajuese për gratë në shërbimin civil që të aplikojnë në pozita vendimmarrëse.

**Me qëllim të rritjes së gëzimit të të drejtave pronësore të grave** - ABGJ i ka propozuar Qeverisë vazhdimin e masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshorteve pa pagesë. Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 01/ 2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Palujtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve, i aprovuar në mbledhjen e Qeverisë, më datë 12.04.2023, me vendimin nr. 07/138. Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për periudhën tetë (8) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi.”

Për derisa në vitin 2016 kemi pasur vetëm 105 qifte që e kanë regjistruar pronën e përbashkët në tërë Kosovën, në 2022 janë 4375 qifte që e kanë bërë këtë Kjo masë afirmative ka ndihmuar në rritjen e qasjes së grave në pronë dhe për herë të parë kemi rritur normën e pronësisë nga gratë në nivel vendi në përqindje prej 19.22”

Me qëllim të priorizimit të procesit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Albin Kurti iu drejtua me një letër zyrtare ministrive të linjës që të kenë prioritet shqyrtimin e secilit rekomandim që është adresuar tani dhe atyre që do të adresohen nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me synim ngritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe respektimin e afatit ligjor prej 30 ditësh për të dhënë të gjitha përgjigjet e kërkuara nga Avokati i Popullit. Gjithashu, në takimet e rregullta të Sekretarve të Përgjithëm të ministrive rregullisht pikë e rendit të ditës (agjendës) është procesi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Është krijuar një

kulturë institucionale për respektimin e detyrimeve kushtetuese për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit dhe për t'i paraqitur të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, brenda afatit ligjor në pajtim me ligjin. Vazhdimisht ka pasur rritje të zbatimit të rekomandimeve, ashtu që niveli i zbatimit të rekomandimeve ka arritur në 28%, që është dukshëm më i lartë sesa në vitet e kaluara. Megjithatë kërkohet më shumë angazhim dhe përkushtim institucional për rritjen e zbatimit deri në arritjen e nivelit kur zbatohen të gjitha rekomandimet. Zyra për Qeverisje të Mirë në vazhdimësi monitoron dhe harton raporte lidhur me situatën e zbatimit të rekomandimeve të IAP adresuar Ministrive dhe Komunave.

Gjithashtu, është punuar në krijimin dhe fuqizimin e sistemit të trajnimit për të drejtat e njeriut, fushata edukimi dhe vetëdijësimi për të drejtat e njeriut.

Janë organizuar aktivitete të shumta (trajnime, tryeza, debate) nga institucionet në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes lidhur me promovimin dhe zbatimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, me fokus në Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin kundër Dhunës në Familje, Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Janë realizuar aktivitete vetëdijësuese me qëllim të vetëdijësimin, ndërgjegjësimin dhe edukimit të publikut për rëndësinë e raportimit të rasteve të diskriminimit se si të paraqesin siç duhet ankesën mbi bazat e diskriminimit, dhe si të raportojnë në mënyrë adekuate diskriminimin.

**Nga maji 2022 është në funksion Platforma Kombëtare për Mbrojtje nga Diskriminimi për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.** Qëllimi i platformës kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi (<https://raportodiskriminimin.org>), është të kontribuojë në parandalimin dhe luftimin e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke ofruar qasje më të lehtë për qytetarët për të raportuar rastet e diskriminimit ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe referimin e tyre në institucionet përkatëse, për të ndërtuar një shoqëri gjithëpërfshirëse.

Bazuar në rastet e raportuara në platformë, në gjithësej 39-të prej tyre, deri më 15.11.2023 dhe 41 deri më 01.12.2023, vërehet se sidomos në gjashtë muajt e fundit të vitit 2023, ka pasur një rritje intensive të raportimit të rasteve. Gjithësej 14 raste të raportuara në platformë, janë regjistruar në periudhën 1 Korrik-1 Dhjetor 2023. Kjo shifër përbën 35% të të gjitha rasteve të raportuara për 17 muaj aktivitet të platformës.

***Gjithashtu rritja intensive e raportimit të rasteve në periudhën Korrik-Dhjetor 2023, tregon rritjen e besimit në punën dhe angazhimin e platformës për shkak të suksesit të rasteve.***

**Ministria e Shëndetësisë:** ka realizur 8 tryeza diskutimi me profesionistët shëndetësorë në QKMF, për zbatimin e ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe linjen e ankesave për qytetarët,

MSh me qëllim të ngritjes së cilësisë në shërbimet shëndetësore dhe me qëllim që qytetarit ti krijohet mundësia që ti shprehe pënaqesitë gjatë marrjes së shërbimeve shëndetësore ka themeluar linjen e ankesave që nga viti 2013 qëllimi i kësaj linje ka qene dhe është me tepër me ngrite cilësinë lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore pa diskriminim.

Në kuadër të aktiviteteve vetëdijësuese, Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ): ka realizuar dy videospote. Vlera totale është 2900.00 euro:

Parandalimin e ngacmimit seksual tek fëmijët

<https://www.youtube.com/watch?v=EqCHdzoEQmY>

Parandalimi i dhunës te çiftet adoleshente

<https://www.youtube.com/watch?v=8RQ7lcjh7OM>

ABGJ ka prezantuar Ligjin për Barazi Gjinore në Qendrën e Shërbimit Korrektues të Kosovës për gratë e burgosura në këtë qendër.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës, ABGJ në bashkëpunim me Institutin e Kosovës së Administratës Publike (IKAP) dhe në mbështetje të asistencës teknike të UN Women, ka realizuar 16 trajnime për Parandalimin dhe Trajtimin e rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës. Janë certifikuar 36 Zyrtare për Barazi Gjinore (ZBGJ) në Ministri dhe Komuna. Në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor janë certifikuar 112 zyrtare të nivelit udhëheqës dhe menaxherial.

Po ashtu me trajnime është vazhduar edhe në nivelin lokal në 11 Komuna: Drenas, Viti, Lipjan, Kline, Deçan, Obiliq, Dragash, Kamenice, Skenderaj, Istog, Prizren, ku janë certifikuar 227 zyrtarë te nivelit udhëheqës dhe menaxherial.

MASHTI zhvilloi dhe realizoi Fushatën një mujore kundër dhunës në shkolla me moton “Së bashku për shkollën miqësore, sipas programit të fushatës (me video promovuese, emisione televizive, seanca me koordinatorë të cilësisë, ligjërata nga UP, seanca me nxënës, etj.);

U realizua Konferenca e Forumit nacional për shkolla miqësore ku MASHTI promovoi të gjitha dokumentet e zhvilluara në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës (Politika e mbrojtjes së fëmijës, Pakoja e 12 moduleve tematike, Doracaku për parandalim të trafikimit, Informatori për konventën e Stambollit; Ligji për mbrojtjen e fëmijës në version miqësor)

Janë zhvilluar Aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit).

Ministria e Mbrojtjes: Në të gjitha kazermat (7 kazerma) e FSK, përmes prezantimeve është promovuar pakoja ligjore për të drejtat e njeriut me qëllim të promovimit të legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave Agjensioni për Barazi Gjinore (ABGJ) ka vazhduar me ciklin e trajnimeve për “Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna ne Familje-. ABGJ ka mbajtur 4 punëtori në nivelin lokal për Mekanizmat koordinues kundër dhunës ne familje, ku janë prezantuar Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, përgjegjësite e nivelit lokal konform Konventës së Stambollit dhe Ligjin për Barazi Gjinore. Punëtorja është mbajtur në këto Komuna: Fushë Kosovë, Deçan, Vushtrri, Lipjan dhe kanë marrë pjesë 72 persona, nga këta janë 46 gra dhe 26 burra. Vlera totale e buxhetit është; 1,326.00 Euro

ABGJ ka realizuar 6 trajnime dy ditore për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në familje dhe dhuna ndaj Grave (2022-2026), ku përmes këtij trajnimi policia informohet, orientohet për përgjegjësitë institucionale konform Procedurave Standarde te Veprimit dhe obligimeve të reja që derivojnë nga Konventa e Stambollit për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

Gjatë muajve janar- dhjetor 2023 janë certifikuar 119 polic, prej tyre 85 burra dhe 34 gra në këto Komuna: Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Vlera totale e këtyre trajnimeve është 6,853.60 Euro.

Numri i trajnimeve të mbajtura gjatë vitit 2023 është 82. Numri i zyrtareve policor të trajnuar për vitin 2023 është 922.

Gjithashtu, Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Komuna e Prishtinës- Me asamblen e fëmijëve të cilët janë zëri i fëmijëve të të gjitha shkollave të kryeqytetit kanë organizuar aktivitete të ndryshme sa i përket parandalimit të diskriminimit dhe 2 aktivitete ku me marrëveshje bashkëpunim me OJQ-të janë mbajtur fushata të tilla në të gjitha shkollat e kryeqytetit.

Në Komunën e Kamenicës-janë ealizuuar aktivitete me shkolla në parandalim të diskriminimit në kontekst të shkollës (parandalim të gjuhës së urrejtjes, dhunës dhe braktisjes së shkollimit). NJKDNJ ka organizuar javën kundër braktisjes së shkollimit ku Koordinatorja e NJKDNJ-së ka përgatitë dhe shpërndar broshura me informacione tek qytetarët e grupmoshave të ndryshme e në veçanti tek nxënësit duke bashkëbiseduar me ta. Informacione më të zgjeruara lidhur me aktivitetet e komunave janë prezantuar Matricen-Formularin e raportimit e i cili document është pjesë e këtij raporti.

**Në Shtojcën 1- Në matricë , në mënyrë të detajuar dhe përshkruese është prezantuar statusi i zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të Objektivit Staregjik 2 ;**

**Në kuadër të Objektivit Staregjik 2 –janë paraparë 3 Nën-objektiva strategjike me gjithësejt 38 aktivitete. Statusi i zbatimit të aktiviteteve është si në vijim:**

**Të zbatuara plotësisht : 34 (tridhjetekatër)**

**Të zbatuar pjesërisht apo në zbatim e sipër: 3 (tre)**

**Aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të; 1 (një)**





**Krahas përparimit dhe progresit të arritur në këtë objektiv strategjik, disa sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen janë:**

- Zbatimi i pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, me fokus në Ligjin për mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Të përmirësohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi institucional ndërmjet nivelit qendror dhe lokal të qeverisjes në aspektin e hartimit dhe zbatimit të politikave publike.
- Institucionet ti japin prioritet zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ofrimit të përgjigjeve Brenda afatit ligjor prej 30-ditësh, si dhe rekomandimeve që i adresohen qeverisë nga mekanizmat ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut dhe shoqëria civile.
- Të mbikëqyret zbatimi i Pakos Ligjore për të drejtat e njeriut (Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjin për Barazi Gjinor dhe Ligji i Avokatit të Popullit).
- Të organizohen programe sistematike të trajnimit në protokollin e Stambollit për të gjithë profesionistët shëndetësorë, avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët.
- Inspektorati i punës ti jap prioritet hetimit dhe trajtimit të ankesave lidhur me rastet e pretenduara të diskriminimit të shkaktuara në sektorin publik dhe privat.
- Qeveria të rritë numrin e inspektorëve/eve.
- Promovimi i Politikës kundër Ngacimit Seksual në organet e administratës publike.

**Objektiva strategjike #3:**

**Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë**

***Sipas Planit të Veprimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në këtë objektiv strategjik priten dy të arritura kryesore:***

- Avancimi dhe zbatimi i kornizës ligjore dhe të politikave në fushën e shëndetësisë, shërbimeve sociale, familjare dhe skemës pensionale;
- Përmirësimi i kushteve të jetës për familjet e varfëra si dhe zvogëlimi i numrit të familjeve të varfëra – përfituese të skemës së ndihmës sociale

**Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:**

Shërbime kualitative shëndetësore dhe sociale për të gjitha kategoritë e shoqërisë

**Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlidhet me:**

Shkalla e mbulueshmërisë së familjeve të varfëra nga Skemat e Ndihmës Sociale

Përpjekjet globale për të ndërtuar një shoqëri të barabartë janë bërë prioritet kyq i agjendës së Kombeve të Bashkuara, në kuadër të së cilës është përcaktuar një synim i dedikuar zvogëlimit të pabarazive (SDGs 10)<sup>1</sup>. Ky objektiv do të jetë në funksion të përmirësimit të shërbimeve sociale, familjare dhe shëndetësore e cila synon fuqizimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe ofrimin e qasjes

<sup>1</sup> UN.2015. Sustainable Development Goals (SDGs) – Agenda 2030.

në shërbime sociale dhe familjare përmes përfundimit të reformave në skemën e ndihmës sociale; harmonizimit dhe avancimit të kornizës ligjore në fushën e shërbimeve sociale dhe shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përcaktimit të sistemit të qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe zbutjen e varfërisë; krijimin e fondit të sigurimeve shëndetësore, ofrimin e shërbimeve dhe programeve për popullatat kyçe vartës nga alkooli dhe droga, personave me HIV-AIDS, personave të prekur nga Tuberkulozi (TBC) etj, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e sigurisë së ushqimit. Gjithashtu, ky objektivi një ndikim të veçantë do ta ketë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave të punëtorëve në përpunime me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Edhe pse gjatë vitit 2023 vrehet një përmirësim në zbatimin e aktivitetetve, **Objektiva e III-të** mbetet ndër objektivat që ka pasur më pak progres në zbatim. Kjo si rrjedhojë e asaj se të gjitha aktivitetet janë të ndërlidhura duke filluar me hartimin dhe ndryshimin e bazës ligjore e cila është ende në fazën fillestare të hartimit dhe harmonizimit me standardet ndërkombëtare si dhe me kërkesat e BE-së dhe *acquis communautaire*

Edhe pse, Fondi për Sigurime Shëndetësore është themeluar me Statutin e Fondit të miraturar në vitin 2016, Funksionalizimi i plotë i Fondit për sigurime shëndetësore pason pas Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces të hartimit. Aktivitetet e parapara në Plan fillojnë së zbatuari pas përfundimit të Plotësim/ndryshimit të Ligjit për Sigurim Shëndetësor i cili është në proces. Edhe përkundër që është punuar në zgjerimin e kapaciteteve me shtretër në Klinikën e Psikiatrisë për personat e nvarur nga drogat, ende nuk ndërtuar Qendra rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike- është inicuar kërkesa nga departamenti i shërbimeve shëndetësore/ divizioni i shëndetit mendore dhe është nënshkruar nga ish- Ministri i Shëndetësisë, mirëpo procesi nuk ka ecur mëtutje.

Në kuadër të këtij objektivi janë ndërmarre aktivitete në fushën e senzibilizimit dhe vedijësimit të opinionit publik lidhur me *mbrojtjen e shëndetit, ambientit dhe parandalimit të dukurive negative në shoqëri si mbrojtja nga sëmundjet ngjitese dhe parandalimi i dukurive negative, si abuzimi me droga, parandalimi i trafikimit me qenie njerzore, dhunës në familje* etj. IKSHPK ka organizuar 8 (tetë) fushata për shënimin e Ditëve botërore të shëndetit: Tuberkulozit, Shëndetit, Duhanit, Substancave narkotike, Zemrës, Hipertensionit, Diabetit dhe HIV/AIDS. Janë organizuar dhe mbajtur 694 aktivitete të edukimit shëndetësor në komunitet, përfshirë ligjeratat për sëmundjet kronike jongjitese, vaksinimin, dukuritë negative, faktorët e rrezikut dhe stili i shëndetshëm i jetës, aktiviteti fizik dhe ushqimi i shëndetshëm, shëndeti dhe sporti, parandalimi i aksidenteve në komunikacion, duke përfshire edhe komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe personat me aftësi të kufizuara.

Sa i përket aspektit legjislativ ende mbetet shume punë për tu bërë. Lidhur me aktivitetin që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tashmë MFPT, të krijojnë bazën Ligjore për sigurimin e të punësuarve nga aksidentet (fatkeqësitë) në punë dhe sëmundjet profesionale, nuk është raportur fare për marrjen e ndonjë nisme. Është themeluar grupi Punues për hartimin e Projekt Ligjit të Skemës së Ndihmës Sociale, pocesit lidhur me përgatitjen e këtij projekt ligji është planifikuar në kuadër të ratifikimit të Marrveshjes me Bankën Botërore për Projektin e Reformës së Skemës së Ndihmës Sociale, e cila marrëveshje ende nuk ka kaluar në Kuvendin e Kosovës. Grupi Punues ka finalizuar Draft-Projeklignin e SNS-së, në Gusht/2023 dhe e ka proceduar tek menaxhmenti i Ministrisë për shqyrtim, para se të procedohej për konsultime paraprake dhe publike. Pas ndryshimeve në Planin Legjislativ të vitit 2023

dhe planifikimeve të MFPT që fillimisht të kemi zbatimin e Pilotimit të Skemës së Asistencës Sociale, ky projektligj është planifikuar për aprovim në pjesën e dytë të vitit 2024.

Ende nuk është kriju granti specific për shërbime sociale dhe familjare. Grupi Punues për përgatitje të formulës së Financimit për Shërbime Sociale pritet të themelohet, pasi ky proces do te varet edhe nga procesi i aprovimit të Ligjit të Financave Lokale, që ishte pjesë e planit legjislativ për vitin 2022.

Ende nuk është finalizuar procesi i hartimit të Ligjit gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara, ende nuk është krijuar granti specifik për shërbime sociale dhe familjare.

**Si pjesë e zbatimit të programeve të mbështetjes së sektorit joqeveritar të licencuara në ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për vitin 2021, 2022 ,2023 të dhënat janë si në vijim:**

<b>MFPT</b>	<b>2021</b>	<b>900.000.00 euro</b>
<b>MFPT</b>	<b>2022</b>	<b>1,000.000.00 euro</b>
<b>MD</b>	<b>2023</b>	<b>1.500.000.00 euro</b>

<b>2021</b>	<b>39 OJQ</b>	<b>përfituese</b>
<b>2022</b>	<b>44 OJQ</b>	<b>përfituese</b>
<b>2023</b>	<b>45 OJQ</b>	<b>përfituese</b>

Ministria e Ekonomisë gjatë vitit 2023 ka hapur Thirrjen publike për mbështetjen e konsumatorëve familjarë në investimin e pajisjeve eficiente për ngrohje; Pajisjeve shtëpiake eficiente, Pompë termike, Kondicioner, Klimë eficiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efijencë të lartë), Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket); Stufa individuale me biomasë si dhe për mbështetjen e ndërmarjeve mikro të vogla dhe të mesme (NMVM), në investimin në pajisje eficiente për ngrohje.

Në kuadër të këtij Objektivit Stategjik mbrojtja e mjedisit zë një kujdes të shtuar. MMPHI -Në kuadër të procesit të ngritjes së Sistemit Informativ Mjedisor, është zhvilluar portali për Cilësinë e ajrit (Air Quality Kosova <https://airqualitykosova.rks-gov.net/en/about-air-quality-portal/>). Po ashtu është zhvilluar edhe Sistemi Informativ për Raportim për Mbeturina, dhe është në proces të funksionalizimit të regjistrit për Kemikate dhe mbeturina të rrezikshme.

Për nevoja të informimit të publikut po ashtu është në dispozicion edhe ueb faqja e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ([www.ammk-rks.net](http://www.ammk-rks.net)) dhe ueb faqja e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (<https://ihmk-rks.net/>). Në të dy këto ueb faqe ofrohen informata për gjendjen e mjedisit dhe në mënyre specifike për gjendjen e ajrit, ujerave, tokës, mbeturinave dhe biodiversitetit.

Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2023 e ka themeluar një trupe ndër- institucionale që do ti koordinonte proceset që ndërlidhen me implementimin e “Agjendës së Gjelbër”. Kjo trupe ndër-institucionale është formuar dhe funksionon në kuadër të projektit EU4Green dhe udhëhiqet nga Zyra e Kryesministrit. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor reflekton Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së dhe bazohet në

pesë shtylla kryesore: dekarbonizimi, ndotja, biodiversiteti, ekonomia qarkulluese (qarkore) dhe sistemet e qëndrueshme të bujqësisë dhe ushqimit.

“EU4Green krijon një shtysë të rëndësishme për ta bërë Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor të pranishme dhe efektive. Agjenda e Gjelbër do të mbështesë njëkohësisht si objektivin drejt një tranzicioni të qëndrueshëm dhe të drejtë të kontinentit, ashtu edhe procesin e anëtarësimit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor në BE,”

Sa i përket nivelit lokal të qeverijes, Komunitet mbeten të përkushtuara në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, deri më tani 27 komuna kanë hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave komunale ndërsa 11 komuna (Gjilan, Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Graçanicë, Leposaviq, Mitrovica e Veriut, Partesh, Zveçan, Klinë) ende nuk kanë hartuar këtë plan. Komunitet në vazhdimësi hasin sfida për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zbatimin e Planit të menaxhimit të mbeturinave komunale për shkaqe të fondeve të pamjaftueshme, mosvetëdijesimit të qytetarëve, mungesës së pagesave nga ana e qytetarëve, numrit të vogël të inspektimeve, mungesës së ndërmarrjeve, stafit jo adekuat për laminë përkatëse, mungesës së pajisjeve të mjaftueshme teknike për kompaninë që menaxhon me mbeturinat etj. Rrjedhimisht Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave, ku vetëm 3 prej tyre kanë hartuar këtë plan.

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, MMPHI gjatë vitit 2023 ka mbajtur dhjetëra aktivitete vetëdijesuese dhe fushata avokimi për të rinjtë lidhur me mbrojtjen e mjedisit në kuadër të shënimit të ngjarjeve mjedisore në kuadër të kalendarit mjedisor për vitin 2023. MASHTI u ka sugjeruar shkollave/ komunave që të realizojnë aktivitete ndërgjegjësuese për planetin në përgjithësi, tema këto që janë pjesë e kurrikulave dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare. Shkollat kanë realizuar aktivitete cilësore dhe të llojlloshme. Janë shënuar edhe datat mjedisore në bashkëpunim me MMPHI, ku edhe MASHTI merr pjesë. Bëhet fjalë për Ditën e ujit, Ditën e Tokës, Ditën e Mjedisit, Biodiversitetit, etj.

Komuna e Prishtinës -Asambleja e fëmijëve të kryeqytetit ka mbajtur fushatë në ditën e tokës dhe në kohën e festave të fund vitit janë bërë dekore me materjale të Ripërdorshme për ti vetëdijësuar të rinjtë tanë për mbrojtjen e mjedisit.

Komuna e Kamenicës- Këshilli i Veprimit Rinor Lokal ka organizuar aktivitete me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të të rinjve për çështjet mjedisore. DKA, përkatësisht shkollat në vazhdimësi organizojnë fushata vetdijësuese lidhur me mbrojtjen e mjedisit qoftë përmes mësimdhënësve të edukatës qytetare, psikologëve dhe pedagogëve në shkolla.

Gjithashtu në kuadër të këtij objektiivi Strategji, ka qenë prioritet sigurimi i sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe mbrojtjen e shëndetit publik dhe Konsumatorit. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitit 2023 për mbrojtjen e shëndetit publik ka realizuar:

81.476 kontrolle zyrtare të operatorëve të bizneseve që merren me ushqim si gjatë importit ashtu edhe ato vendore.

Këto kontrolle janë realizuar nga inspektorët veterinarë, fitosanitarë dhe sanitarë, sipas fushave relevante të inspektimit dhe natyrës së produkteve.

Nga këto kontrolle janë testuar 3.592 mostra të analizuara në laboratore brenda dhe jashtë vendit!

Produktet të cilat ishin jo conform rregullave shëndetsore janë asgjësuar si vijon:

374,770 kg produkte të mishit;

74,522 kg produkte të qumështit; 4.842 kg mjaltë; 125 kg peshk; 155,491 kg produkte fitosanitare; 950,565 kg produkte të përziera sanitare;

Nga sëmundjet ngjitëse të kafshëve janë asgjësuar 345 krerë gjedhe; 29 krerë dhenë dhe dhi; 1082 derra dhe 171 koshere bletësh.

48 ngarkesave iu është rrefuzuar importi në Republikën e Kosovës

**Në Shtojcën 1- Në matricë , në mënyrë të detajuar dhe përshkruese është prezantuar statusi i zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të Objektivit Staregjik 3 ;**

**Në kuadër të Objektivit Staregjik 3 –janë paraparë 4 Nën-objektiva strategjike me gjithësejt 37 aktivitete. Statusi i zatimit të aktiviteteve është si në vijim:**

**Të zbatuara plotësisht : 26 (njëzetegjashtë)**

**Të zbatuar pjesërisht apo në zbatim e sipër: 6 (gjashtë)**

**Aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të; 5 (pesë)**



**Krahas përparimit modest të arritur në këtë objektiv strategjik, disa sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen janë:**

- Të hartohet dhe aprovohet Ligji për Sigurime Shëndetësore.
- Të funksionizohet Fondi për Sigurime Shëndetësore.

- Të ndërtohet Qendra rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike.
- Hartimi dhe zbatimi i planeve për mbrojtjen e mjedisit dhe ajrit, në nivel lokal të qeverisjes.
- Të përmirësohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi institucional ndërmjet nivelit qendror dhe lokal të qeverisjes në aspektin e hartimit dhe egzekutimit të politikave publike.
- Institucionet ti japin prioritet zbatimit të drejtave të punëtorve në sektorin publik dhe privat në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.
- Të mbikëqyret zbatimi i Politikës kundër ngacmimit seksual në organet e administrates publike.
- Të organizohen programe sistematike të trajnimit për inspektorët e punës në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe ngacmimi seksual.
- Inspektorati i punës ti jap prioritet hetimit dhe trajtimit të ankesave lidhur me rastet e pretenduara të diskriminimit të shkaktuara në sektorin publik dhe privat;
- Qeveria të rritë numrin e inspektorve, sidomos të rritet numri i femrave inspektore.
- Të krijohet granti specifik për shërbime sociale dhe familjare.
- Sa i përket aspektit legjislativ ende mbetet shume punë për tu bërë. Lidhur me aktivitetin që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tashmë MFPT, të krijojnë bazën Ligjore për sigurimin e të punësuarve nga aksidentet (fatkeqësitë) në punë dhe sëmundjet profesionale, nuk është raportur fare për marrjen e ndonjë nisme.
- Të hartohet dhe aprovohet Ligji i Skemës së Ndihmës Sociale.
- Të aprovohet Ligji gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara.

#### **Objektiva strategjike #4: Lehtësimi i qasjes në sistemin e drejtësisë**

***Sipas Planit të Veprimit të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore, të njeriut në këtë objektiv strategjik priten dy të arritura kryesore:***

- Qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë dhe pa diskriminim;
- Qasje më të madhe në drejtësi si dhe sundim dhe funksionim më efikas të ligjit përmes instrumenteve jashtë gjyqësore

#### **Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:**

Trajtimi i drejtë dhe i barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë;

#### **Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlidhet me:**

% e lëndëve të zgjidhura përmes instrumenteve jashtë gjyqësore

Qeveria e Kosovës i bashkohet aspiratave të të gjitha shteteve palë në kuadër të OKB-së, që njëherit është edhe objektiva e 16-të e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm, të mobilizohen për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse, për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë dhe për të

ndërtuar institucione efektive, të përgjegjshme llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e qeverisjes<sup>1</sup>. Të gjithë hapat e planifikuar në kuadër të kësaj Objektivë Strategjike janë në harmoni me Strategjinë e miratuar për Sundimin e Ligjit (2021-2026).

Në përputhje me këtë Objektivë Strategjike -Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në vazhdimësi ka promovuar përdorimin e Ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore. Gjithashu, KGJK në vazhdimësi ka ndërmarr veprime për zvogëlimin e lëndëve, duke shtuar numrin e gjyqtarëve të ri duke bërë rekrutimin e 49 gjyqtarëve dhe shtimin e stafit mbështetëses, po ashtu KGJK-ja ka miratuar Planin strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi (2022-2025) efikasiteti dhe prioritizimi i lëndëve brenda sistemit gjyqësor, ku do ti jepet prioritet lëndëve që janë afër parashkrimit. KGJK-ja në vazhdimësi i shqyrton kërkesat për iniciimin e procedurave disiplinore që vijnë nga Autoritetet Kompetente konform Ligjit Nr. 06/L-057 për përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. KGJK-ja ka krijuar lehtësirat për përdorimin e Gjuhëve, ka bërë lincësimin e përkthyesve dhe intepretëve gjyqësor, procesi i cili ka qenë i mbikëqyrur edhe nga partnerët ndërkombëtar.

Reduktimi dhe zgjedhja e lëndëve të vjetra, përmes përfshirjes së profesioneve të lira ligjore, ku përfshihen ndërmjetësimi (ndërmjetësuesit), noterët e përmbauesit privat. Edhe pse ndërmjetësimi ka filluar të aplikohet relativisht vonë, statistikat tregojnë se ka ngritje graduale të rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit. Deri më tani janë referuar rreth 11,530 (nuk përfshinë vitin 2016, në tre regjione) raste në procedurë të ndërmjetësimit, dhe kanë rezultuar me arritje të zgjidhjes së mosmarrëveshjes rreth 9,320 raste. Ajo që mund të vërehet nga këto statistika janë rezultatet e marrëveshjes me zgjidhje të suksesshme. Arsye më shumë për të zgjidhur ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ministria e Drejtësisë do t'i publikojë rregullisht të dhënat e rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit

Arsye më shumë për të zgjidhur ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, janë rezultatet e marrëveshjes me zgjidhje të suksesshme. Ministria e Drejtësisë do t'i publikojë rregullisht të dhënat e rasteve të referuara në procedurë të ndërmjetësimit.

Ndërmjetësuesit e parë janë licencuar në 2011 dhe aktualisht janë diku rreth 180 ndërmjetësues të licencuar nga Ministria e Drejtësisë në tërë Kosovën, të profileve të ndryshme të gatshëm të ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Numri aktual është gjithsejtë 50 (pesëdhjetë e pesë) Noterë;

- Në vitin 2023 gjithsejtë janë përpiluar/hartuar 644,866 vërtetime/akte, prej tyre 484,039 vërtetime noteriale si dhe 160,827 akte noteriale, këto të dhëna janë sipas raportit vjetor për vitin 2023 të Odes së Noterëve.

Përmbaues Privat, numri aktual është gjithsejtë 42 (tridhjetë e nëntë);

Në vitin 2023 sips raporteve të Përmbauesve Privat gjithësejtë janë si në vijim:

- Numri i lëndëve të pranuar është 26,090
- Numri i lëndëve të zgjidhura është 7,482

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në vazhdimësi ka promovuar përdorimin e Ndërmjetësimit si metodë alternative për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore.

Informacione më të zgjeruara ofrohen në [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736\\_KGJK\\_RAPORTI\\_VJETOR\\_2023.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/40736_KGJK_RAPORTI_VJETOR_2023.pdf)

MD e ka hartuar draftin e Koncept dokumentit për realizimin e të drejtave civile, përfshirë të drejtën e palëve në gjykim brenda kohës së arsyeshme, janë mbajtur dy punëtori me përkrahjen e Programit për Drejtësi – EUKOJUST, si dhe janë angazhuar dy ekspert vendor. Më 29.6.2023 është miratuar Koncept Dokumenti për realizimin e të drejtave civile përfshirë të drejtën e palëve për gjykim brenda kohës së arsyeshme.

Me datë 14.1.2023, është miratuar Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe Trajtimin e Fëmijëve Kryerës të Veprave Penale nën Moshën e Përgjegjësisë Penale. Ky Udhëzim ka paraparë Ndërmjetësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve me qëllim të dhënies së mundësisë së kthimit të raporteve normale në mes të bashkëmoshatarëve dhe rehabilitimit të fëmijës dhe re-integrimit të tij në shoqëri.

***Ka vazhduar Përmirësimi i zbatimit të drejtës për ndihmë juridike falas.*** Me ndryshimet ligjore që janë bërë gjatë vitit 2022 është bërë lehtësimi i qasjes në drejtësi për disa kategori të qytetarëve, kjo me Ligjin Nr. 08/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-017 për Ndhmë Juridike Falas, ku janë përcaktuar kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës juridike falas ku pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik (pra, pa i shikuar fare kriteret) ndihma juridike falas i ofrohet:

- 1.1. personave të dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999;
- 1.2. viktimave të dhunës në familje;
- 1.3. viktimave dëshmitare të dhunës, të cilët janë në varësinë e viktimave të dhunës në familje;
- 1.4. viktimave të dhunës në baza gjinore;
- 1.5. viktimave të cilitdo lloj të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual;
- 1.6. viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;
- 1.7. viktimave të mitur;
- 1.8. fëmijëve që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- 1.9. fëmijëve nën kujdestari që kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- 1.10. personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent sipas ligjit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi;
- 1.11. Gazetarëve, gazetarëve të pavarur, fotoreporterëve, kameramanëve dhe redaktorëve që punojnë në/për media të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe/ose në media anëtare në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Agjensioni për Ndhmë Juridike Falas (ANJF), me qëllim të informimit dhe vetëdijësimit ANJF organizon dhe bëhet pjesë e këtyre fushatave të ndërgjegjësimi: - Java e Ndhmës Juridike Falas me moton



“Mbroj të drejtën tënde”, janë mbajtur konferenca, takime informuese me akter të ndryshëm komunal, është bërë informimi i qytetarëve përmes shpërndarjes së 5000 broshurave në 4 gjuhë shqip, serbisht, anglisht dhe turqisht si dhe në alfabetin BRAIL, 80 posterëve, 3 spoteve televizive, publikimeve në web faqe dhe rrjete sociale, 5 paraqitjeve në media, ligjeratave në institucione dhe me grupe të interes publik; me komitetet jo shumicë. Si rezultat i këtyre fushatave është regjistruar numër më i madh i përfituesve të ndihmës juridike falas, por ende nuk është arrit qëllimi në tërësi.

Në vitin 2023 ndihma juridike falas u është ofruar 2883 femrave dhe 3187 meshkujve. Sipas përkatësisë etnike prej tyre ndihmë juridike falas kanë përfituar 5214 shqiptar, 164 serb, 73 boshnjak, 54 turk, 213 ashkali, 156 egjiptian, 137 rom, 54 goran dhe 5 të tjerë.

Krahasuar me vitin 2021 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 31.95 %, ndërsa krahasuar me vitin 2022 kemi rritje të numrit të përfituesve të ndihmës juridike falas për 3.56 %.

Në periudhën raportuese për vitin 2023 janë angazhuar 584 (pesëqind e tetëdhjetë e katër) avokatë, prej tyre në procedurë civile 539 (pesëqind e tridhjetë e nëntë), në procedurë administrative 14 (katërmbëdhjetë) dhe në procedurë penale 31 (tridhjetë e një). Krahasuar me vitin paraprak kemi rritje të angazhimit të avokatëve për 4.84 %.

ANJF me të gjitha të arriturat në ofrimin e shërbimeve juridike për qytetarët, është përcjellë edhe me sfida të ndryshme. Sfidat me të cilat është përballur ANJF, janë si pasojë e buxhetit të pamjaftueshëm për arritjen e objektivave në mënyrë të plotë.

Poashtu plotësim ndryshimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ka rritur gamën e përfituesve të ndihmës juridike falas, e që njëkohësisht rritë edhe nevojat për buxhet shtesë. Duke pasur parasysh se buxheti aktual i ndarë për ANJF është i ulët, me zgjerimin e gamës së përfituesve të ndihmës juridike falas do të ketë vështirësi në zbatimin e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, në rast se nuk ofrohet përkrahje buxhetore.

Për të arritur përmbushjen e obligimit ligjor në vazhdimësi përmes kërkesave buxhetore, është apeluar për të siguruar buxhetin e nevojshëm për hapjen e Zyrave Mobile, mirëpo në ligjin e buxhetit të vitit 2022 nuk është ndarë buxhet për të siguruar shtrirjen e ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në Qershor të vitit 2023 është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë, Rregullorja MD - NR. 05/2023, për përcaktimin e kriterëve për ofrimin e ndihmës juridike falas nga OJQ-të që hynë në partneritet me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Andaj bazuar në rregullore janë përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme; është hapur thirrja publike për OJQ-të për aplikim për hyrje në partneritet, është formuar Komisioni për vlerësimin e kriterëve dhe nga velrësimet e Komisionit, gjashtë OJQ kanë plotësuar kriteret e përcaktuara në rregullore.

Lidhur me sigurimin e qasjes në drejtësi, ANJF, në vazhdimësi ka bërë përpjekje për sigurimin e qasjes në drejtësi për qytetarët që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, veçanërisht për viktimat e dhunës në baza gjinore, dhunës seksuale, komuniteteve jo-shumicë dhe personat e zhvendosur. Me qëllim të arritjes së informacionit tek komunitetet jo shumicë gjatë vitit 2023 janë mbajtur: 6 Sesione informative ligjore me komunitetin Rom për Qasjen në Drejtësi së bashku me Eukojust në rajone të ndryshme të Kosovës.

ANJF është ballafaquar me sfida të konsiderueshme për arritjen e objektivave si pasojë e mungesës së buxhetit për shtrirjen e Ndhmës Juridike në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 22, të Ligjit për Ndhmë Juridike Falas, ku parashihet themelimi i Zyrave Rajonale dhe Zyrave Mobile për Ndhmë Juridike Falas për të mbuluar tërë territorin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të siguruar qasje efikase në sistemin e drejtësisë të përfitojnë shërbime të ofrimit të Ndhmës Juridike Falas.

Aktualisht, Ndhma Juridike Falas ofrohet nëpërmjet 7 (shtatë) zyrave rajonale për ndihmë juridike falas të cilat funksionojnë në: ZRNJF Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Gjilan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe përmes 14 (katërmëdhjetë) zyrave mobile të cilat funksionojnë në komunat në vijim: Fushë Kosovë, Drenas, Deçan, Istog, Suharekë, Dragash, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok, Malishevë, Graçanicë, Skënderaj dhe Kamenicë. Këto zyra financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Ndhma juridike falas ofrohet edhe përmes 6 zyrave mobile të përkrahura financiarisht nga GIZ-i të cilat funksionojnë në komunat: Podujevë, Klinë, Lipjan, Shtime, Kaçanik dhe Hani i Elezit, duke mundësuar punësimin e 4 zyrtarëve të cilët do ofrojnë ndihmën juridike falas. Poashtu ndihma juridike falas ofrohet edhe përmes Klinikës Mobile Lëvizëse e përkrahur financiarisht nga UNDP, e cila funksionon në komunat ku nuk ka zyrë rajonale dhe zyrë mobile për ndihmë juridike falas dhe në rajonet me të thella të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna ka hasur përkrahje nga Ministria e Drejtësisë. Me qarkoren e fundit buxhetore të vitit 2024 janë siguruar 4 (katër) pozita zyrtar ligjor për zyrat mobile të përkrahura nga GIZ, e po ashtu është lejuar edhe 1 (një) pozitë zyrtar ligjor për hapjen e zyrës mobile edhe në një Komunë tjetër.

Po ashtu edhe buxheti i ANJF-së në kategorinë mallra dhe shërbime është rritur për 40,000,00 € për vitin 2024.

**Funksionimi i sistemit të ndërmjetësimit;** KGJK-ja në bashkëpunim me USAID është duke e bërë promovimin e Ndërmjetësimit përmes mjeteve të informimit, rrjeteve sociale dhe broshurave.

Gjatë vitit 2021 janë miratuar dy Udhëzime Administrative për ndërmjetësimin,

- Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 05/2021 për përcaktimin e procedurës së ndërmjetësimit të vetinimit të rasteve dhe rasteve të referuara nga organi administrativ,
- Udhëzim Administrativ MD-Nr. 4/2021 Për tarifën e ndërmjetësuesve në Republikën e Kosovës.

Statistikat e rasteve në procedurën e ndërmjetësimit për vitin 2021 të referuara nga gjykatat dhe prokuroritë themelore. Rastet e referuara nga gjykatat; Rastet penale kanë qenë gjithësej 2232 raste, prej tyre të zgjedhura 1830, të pa zgjedhura 383 në procedurë. Rastet civile, kanë qenë gjithësej 887 raste, prej tyre të zgjedhura kanë qenë 642, të pa zgjedhura 222, në procedurë 23. Totali i 3119.

Rastet e referuara nga prokurorit në vitin 2021 kanë qenë 2315, prej tyre janë zgjedhur 1765 raste, të pa zgjedhura 308 raste dhe në punë 240 raste.

**Ka vazhduar Lehtësimi i barrierave për mbrojtjen e viktimave të krimit**, në veçanti për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje;

Në periudhën Janar-Dhetor 2023, nga programi për kompenzim kanë përfituar 129 (njëqind e njëzet e nëntë) viktima. Shuma totale e taksës për kompenzimin e viktimave të krimit në vitin 2023 ka qenë 228,978.00€.

**Në vitin 2023 janë pranuar 129 kërkesa për kompenzim.**

- **24 kërkesa janë refuzuar**
- **98 janë aprovuar**
- **7 në punë.**

<b>Vlera totale e kompenzimit 228,978.00€.</b>	
Dhunë në familje	<b>39 raste</b>
Dhunim	<b>11 raste</b>
Keqpërdorim seksual i fëmijëve	8 raste
Ngacmim seksual	<b>9 raste</b>
Krime Lufte	<b>12 raste</b>
Trafikim me qenje njerëzore	<b>3 raste</b>
Vrasje	<b>13 raste</b>
Vrasje në tentative	<b>9 raste</b>
Lëndim i rënd trupor	<b>13 raste</b>
Lëndim i let trupor	<b>10 raste</b>
Grabitje	<b>1 rast</b>

Divizioni për mbështetjen e viktimave të krimit së bashku me partnerët e vet, ka mbajtur trajnime me Gjyqtarë, Prokurorë, Mbrojtës të Viktimave, Punëtor Social, Policia e Kosovës, Njësi e Trafikimit me Qenie Njerëzore, OJQ të ndryshme të cilët janë informuar për të drejtën e viktimave në kompensim. Është realizuar fushatë informuese për të drejtat e viktimave në kompensim përmes panove apo posterave informuese, fletëpalosjeve, broshurave të cilat janë vendosur dhe shpërndarë në institucionet relevante dhe OJQ-të e ndryshme.

Janë përditësuar informacionet në linkun e web faqes së MD-së. Linku -<https://md.rks.gov.net/page.aspx?id=1,103>

Organet e sigurisë (Policia e Kosovës), ka në përdorim kartelën e viktimave ku viktima njoftohet me disa informata qysh nga momenti i hapjes së rastit dhe për viktimat e dhunës në familje, dhe viktimat tjera të cilat kanë të drejt kompenzimi sipas legjislacionit në fuqi njoftohen çdo herë nga zyrtarë policor. Në kartelën elektronike figuron edhe pika për njoftimin e viktimës së krimit për të drejtën e kompenzimit sipas ligjit.

Policia e Kosovës në të gjitha rastet kur bjen në kontakt me viktimat i informon lidhur me të drejtat e tyre të cilat burojnë nga legjislacioni në fuqi. Gjatë vitit 2023 Policia e Kosovës ka lansuar edhe fletushkën NDAL DHUNËN NË FAMILJE, ku në brendi të kësaj fletushke janë të listuara edhe të drejtat e viktimave të dhunës në familje.

**Ka vazhduar Realizimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave,** të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve. Sa i përket realizimit të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve përmes Zbatim të vendimeve të plotfuqishme të vendosura nga AKKVP-së, numri i vendimeve të plotëfuqishme të zbatuara është 324.

Numri i urdhrave për dëbim të zbatuara në periudhën raportuese është 5. Në pritje janë 65 urdhra për dëbim ku 90 % e këtyre pronave janë në veri të vendit.

Policia e Kosovës ka asistuar Agjencinë e Pronave në 51 raste.

Konform Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme 01/2008, Qeveria e Kosovës me Vendimi Nr.13/116 datë 28.12.2022. ka themeluar Komisionin Qendror për Ankesa Eshtë zbatuar.

Ka vazhduar me pas efekte positive zbatimi i Masës afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë. ABGJ propozoi për miratim Qeverisë vazhdimin e masës afirmative “Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë.” UA është vazhduar edhe për një vit prill 2023-prill 2024. Nga kjo masë afirmative për periudhën janar- dhjetor 2023 janë regjistruar 5050 (pesë mijë e pesëdhjet) prona në emër të dy bashkëshorteve. ABGJ me synim të senzibilizimit për të drejtat pronësore të grave dhe përfitimet përmes aplikimit të masës afirmative ka realizuar një videospot televiziv për Udhëzimin Administrativ për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve-pa pagesë

**Në Shtojcën 1- Në matricë , në mënyrë të detajuar dhe përshkruese është prezantuar statusi i zbatimit të aktiviteteve të parapara në kuadër të Objektivit Staregjik 4 ;**

**Në kuadër të Objektivit Staregjik 4 –janë paraparë 5 Nën-objektiva strategjike me gjithësejt 29 aktivitete. Statusi i zbatimit të aktiviteteve është si në vijim:**

**Të zbatuara plotësisht : 25 (njëzetepesë )**

**Të zbatuara pjesërisht apo në zbatim e sipër: 4 (katër )**

**Aktiviteti nuk është zbatuar dhe nuk ka asnjë zhvillim lidhur me të (0)**



**Krahas përparimit të arritur në këtë objektiv strategjik, disa sfida të cilat duhet të adresohen në të ardhmen janë:**

- Të finalizohet dhe aprovohet nga Qeveria Ligji për realizimin e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas ka rritur gamën e përfituesve të ndihmës juridike falas, e që njëkohësisht rritet edhe nevoja për buxhet shtesë.
- Të vazhdohet me fushata vetëdijuese lidhur me informimin e qytetrave lidhur me të drejtat e tyre për qasje në sistemin e drejtësisë, ndërmjetsimin, ndihmën juridike falas etj.
- Duhet të vazhdohet me realizimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave, të drejtave pronësore të komuniteteve dhe të PZH-ve.
- Të sigurohet buxhet adekuat për kompensimin e viktimave të krimit.
- Të organizohen programe sistematike të trajnimit për zyrtarët e sundimit të ligjit.

**1.1 Rreziqet/Sfidat dhe masat lehtësuese**

Edhe ky raport rrjedhimisht thekson nevojën për përmirësimin e kapaciteteve ligjore institucionale dhe të politikve në fushat e të drejtave të njeriut. Koordinimi ndërinstytucional në aspektin e hartimit dhe egzekutimit të politikave publike duhet të merr kujdes dhe vëmendje më të shtuar, sidomos nga vendimmarrësit.

Ministritë dhe komunitat duhet të jenë më pro-active në realizimin e aktiviteteve të cila janë paraparë në Planin e Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Programit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore (2021-2025), e të cilat janë me rëndësi jetike për qytetarët e vendit.

### **Sfidat që vazhdohet të mbesin të veçuara janë:**

- Zbatimi I pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, e me theks të veçantë zbatimi I Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminim mbetet sfidë.
- Zbatimi I Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ende nuk ka përfunduar hartimi I Ligjit gjithëpërfshirë për personat me aftësi të kufizuara.
- Fuqizimi dhe funksionalizimi I mekanizmeve institucional për mbrojtjen nga Diskriminimi në Ministri dhe Komuna konform plotësim ndryshimeve që janë duke u bërë në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Ligji për Sigurimin Shëndetsorë ende nuk është finalizuar.
- Ende qytetarët e Republikës nuk gëzojnë sigurim shëndetsorë.
- Kërkesa buxhetore e ANJF-së për të hapur Zyrat Mobile edhe në 6 komuna nuk ka hasur ende në përkrahje.
- Ende nuk është caktuar formula për grantin specifik për shërbime sociale dhe familjare.
- Përkushtimin afatgjatë i Qeverisë për të garantuar zbatimin e masave të parapara në kuadër të Programit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

### **Parandalimi dhe eliminimi i pengesave për mos- zbatim të Programit për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë themelore duhet të fokusohet te:**

- Grupi Koordinues Ndërinstitucional për të drejtat e njeriut të demonstroi rol më proaktiv në monitorimin e zbatimit të këtij programi dhe planit të veprimit për zbatimin e tij, duke kërkuar llogaridhënje institucionale lidhur me progestin dhe sfidat karshi zbatimit të tij.
- Një linjë e veçantë e buxhetit apo buxhet shtesë të parashihet për Agjencionin për Ndihmë Juridike Falas, me qëllim të shtrirjes dhe mbulimit të ndihmes juridike falas për tërë vendin.
- Të funksionalizohet Njësia Qendrore për përkthim dhe harmonizim të legjislacionit drejt një legjislacioni të harmonizuar shumëgjuhësh.
- Të aprovohet Ligji për Sigurimin Shëndetsorë, I cili do të pasonte me hapat tjerë drejtë sigurimit të kushteve për ofrimin e sigurimit shëndetsorë për qytetarët e vendit.
- Të ndërtohet Qendra rehabilituese për personat në varësi të substancave narkotike.
- Qeveria të rritë numrin e inspektorëve, sidomos të rritet numri i femrave inspektore.
- Të krijohet granti specifik për shërbime sociale dhe familjare.
- Të finalizohet dhe aprovohet Ligji gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara.
- Hartimi dhe zbatimi I planeve për mbrojtjen e mjedisit dhe cilësië e ajrit, në nivel lokal të qeverisjes.
- Të përmirësohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi institucional ndërmjet nivelit qendror dhe lokal të qeverisjes në aspektin e hartimit dhe egzekutimit të politikave publike
- Institucionet ti japin prioritet zbatimit të drejtave të punëtorëve në sektorin publik dhe privat në përputhje me legjislacionin e fuqi dhe standardet ndërkombëtare.
- Qeveria dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të ndajnë burime financiare për realizimin e aktiviteteve për të cilat janë përgjegjëse.

## 1.2 Përfundimet

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive theelore të njeriut (2021-2025) u miratua në tetor të vitit 2021, me Plan të detajuar të Veprimit për periudhën (2021-2023). Ky është një dokument që e konfirmon përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin socio-ekonomik të vendit të bazuar mbi largimin e pengesave ndaj përmbushjes së të drejtave dhe lirive themelore, përfshirë atyre ekonomike, që do të ndihmojnë qytetarin të punojë, konsumojë dhe të jetojë me dinjitet e në paqe. Mbi supet e Republikës qëndron përgjegjësi e madhe: të sigurojë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke respektuar standardet e mishëruara në konventa ndërkombëtare e atyre brenda praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përmes Programit, Qeveria e Kosovës do t'i përmbushë detyrimet pozitive që dalin nga njohja e çdo të drejte universale të njeriut, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim. Brenda këtij kuadri të gjithë personave u jepet mundësia të gëzojnë të drejtat e tyre, përderisa gëzimi i tyre nuk cenon të drejtat e të tjerëve. Në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit si një mekanizëm i pavarur për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Komisionit Evropian, OJQ-ve vendore dhe mekanizmave ndërkombëtarë dhe rajonal për të drejtat e njeriut do të merren parasysh, dhe të njëjtat do të zbatohen nga ana e institucioneve kompetente konform Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi.

Katër objektivat strategjike në kuadër të Programit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive theelore të njeriut (2021-2025) i pasqyrojnë prioritetet për një shoqëri gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe padiskriminim, e të cilat suhohen të arrihen përmes objektivave në vijim:

Ato janë:

- ✚ Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;**
- ✚ Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;**
- ✚ Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;**
- ✚ Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.**

Është me rëndësi që të theksohet se Zyra për Qeverisje të Mirë është mekanizmi kryesor Koordinues për monitorimin e zbatimit të Programit për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë themelore.

Programi është duke u zbatuar mirë, me disa vonesa të vogla, gjithësesi ka vend për përmirësim dhe zhvillim tutuje të procesit. ZQM/ZKM-ja, përveq rolit Koordinues dhe momitorues ka qenë maksimalisht e angazhuar në zbatimin e disa aktiviteteve të parapara në kuadër të planit të veprimit. Në total, në Program janë planifikuar 124 aktivitete. Prej tyre 104 aktivitete janë zbatuar, 14 të zbatuara pjesërisht apo në zbatim e sipër si dhe 6 nuk janë zbatuar.

Po ashtu, duhet të theksohet që ka pas aktivitete të zhvilluara të cilat I kanë tejkaluar masat e planifikimit, jashtë saj që ka qenë e planifikuar në dokument.si p.sh. Është themeluar Ekipin ndërinstytucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe

Egjiptian në Republikën e Kosovës, është lansuar dhe funksionalizuar Platforma Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, është hartuar Kalendar i aktiviteteve për vitin 2022-Vit i personave me aftësi të kufizuara etj.

Përparimi kryesor është arritur në **Objektivin Strategjik 1 si dhe Objektivin Strategjik 2**. Fokusi i angazhimeve të Institucioneve në nivelin qendror dhe lokal të qeverisjes duhet të orientohet te Objektiva Strategjike 3 dhe Objektiva Strategjike 4. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me institucionet e tjera relevanter e ka finalizuar këtë raport i cili përfshinë periudhën e vlerësimit për vitin (2023), duke prezantuar progresin si dhe sfidat gjatë zbatimit të Planit të Veprimit për vitet (2023-2025) për Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore.

### **1.3 Disa praj arritjeve më të rëndësishme gjatë kohës së raportimit janë si në vijim:**

- Është themeluar dhe funksionalizuar Gupi Koordinues Ndërinstitucional për të Drejtat e Njeriut
- Është ri-funksionalizuar Këshilli për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Këshilli vepron si organ këshillëdhënës dhe orientues për përcaktimin e prioritetëve dhe politikave në fushën e Atësisë së Kufizuar (këta dy mekanizma kryesohen nga Znj.Emilija Rexhepi-Zëvendëskryeministre për për Çështje të Pakicave dhe Drejtat e Njeriut).
- Është funksionalizuar Komitetit Ndërmintor për të Drejta të Fëmijëve, kryesuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti.
- Është hartuar Raporti shtetëror lidhur me zbatimin e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.
- Është themeluar Ekipi ndërinstitucional për nxitjen dhe promovimin e punësimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës,
- Është lansuar dhe funksionalizuar Platforma Kombëtare për raportimin e rasteve të diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës.
- Është hartuar Raporti vjetor për Vitin 2023 lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi bazuar në rastet e raportuara në platformën kombëtare për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian” në katër gjuhë; në gjuhën shqipe, serbe, angleze dhe rome.
- Është aprovuar Korniza e Treguesve Kombëtar për të Drejtat e Njeriut.
- Është hartuar Korniza e treguesve për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Është hartuar Udhëzuesi për zbatimin e Politikës kundër ngacmimit seksual në organet e Administratës Publike dhe ngritja e kapaciteteve për zbatimin e saj.
- Është hartuar e publikuar Raporti për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 2023.



## **Shtojca**

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut po zbatohet në linjë me Planin e Veprimit. Gjegjësisht, Programi i ka: katër objektiva strategjike, 16 objektiva specifike, 33 tregues dhe 124 veprime të ndryshme. Më poshtë në këtë raport, është paraqitur përparimi i zbatimit të Programit dhe Planit të Veprimit për vitin (2021-2023).

Janë përdorur të gjitha të dhënat në dispozicion nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ministritë, komunat dhe institucionet e tjera të mbledhura përmes ueb faqeve dhe komunikimeve të drejtpërdrejta me e-mail.

### **OBJEKTIVA STRATEGJIKE janë IV**

- 16 OBJEKTIVA SPECIFIKE
- 124 AKTIVITETE/
- 33 TREGUES

#### **1. OBJEKTIVA STRATEGJIKE I**

- 04 Objektiva Specifike
- 20 Aktivitete

#### **2. OBJEKTIVA STRATEGJIKE II**

- 03 Objektiva Specifike
- 38 Aktivitete

#### **3. OBJEKTIVA STRATEGJIKE III**

- 04 Objektiva Specifike
- 37 Aktivitete

#### **4. OBJEKTIVA STRATEGJIKE IV**

- 05 Objektiva Specifike
- 29 Aktivitete

- 09 Aktivitete – kanë qenë të planifikuara për vitin 2021
- 37 Aktivitetet – kanë qenë të planifikuara për vitet 2021-2022
- 78 Aktivitete – kanë qenë të planifikuara në vazhdimësi për vitet 2021-2023

**Përmbledhja e nivelit të zbatimit të aktiviteteve për vitet (2021-2023) është si në vijim:**

Objektivat Strategjike	Veprimet planifikuara për vitin 2021-2022	Statusi i zbatimit të veprimeve në vitin 2021-2022
1. Përmirësimi i qeverisjes, transparencës, koordinimit institucional dhe i llogaridhënies brenda institucioneve publike për të realizuar më tej të drejtat e njeriut;	<b>20 aktivitete të planifikuara</b>	të zbatuara ( 19 janë të zbatuara), në zbatim e sipër (1 janë në zbatim e sipër) të pa zbatuar (0 e pazbatuar)
2. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut;	<b>38 aktivitetet të planifikuara</b>	të zbatuara (33 janë të zbatuara) në zbatim e sipër (3 janë në zbatim e sipër) të pa zbatuar (1 të pazbatuara)
3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë;	<b>37 aktivitetet të planifikuara</b>	të zbatuara ( 26 janë të zbatuara) në zbatim e sipër ( 6 janë në zbatim e sipër) të pa zbatuar ( 5 të pazbatuara)
4. Lehtësimi i Qasjes në Sistemin e Drejtësisë.	<b>29 aktivitetet</b>	të zbatuara (25 janë të zbatuara) në zbatim e sipër (4 në zbatim e sipër) të pa zbatuar (0 të pazbatuara)
<b>Totali</b>	<b>124 aktivitete kanë qenë të planifikuara në total</b>	- të zbatuara ( 104 të zbatuara) - në zbatim e sipër (14 në zbatim e sipër) - të pa zbatuara (6 të pazbatuara)